



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM PËR SHTYP

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Energy Plus SHPK nga shoqëria Duferco Pobreg SHPK

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.374 prot., i AK, datë 13.08.2021 “Njoftim Përqendrimi”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Energy Plus SHPK nga shoqëria Duferco Pobreg SHPK.

Referuar “Marrëveshje paraprake shitblerje” palët janë:

Pala blerëse: *Duferco Pobreg SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: studimin, konsulencën, projektimin, prodhimin, realizimin, tregtimin e projekteve të investimit të centraleve, të linjave të transportit të energjisë elektrike, të impianteve në përgjithësi në sektorin e energjisë nga burime të rinovueshme në Itali dhe jashtë saj, menaxhimin e impianteve si në pikën më sipër, prodhimin e energjisë elektrike dhe tregtimin e saj, edhe nëpërmjet veprimtarisë së tregtimit, etj.

Pala shitëse:

1. *Agj Kons SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Veprimtari në fushën e ndërtimit të përgjithshëm, veprimtari në fushën e projektimit, tregtim materialeve ndërtimi, import-eksport, etj.

2. *Energy Development Group SHA*, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: Studimi, projektimi, konsulenca sipërmarrja zbatuese dhe/ose investimi për realizimin me fonde publike dhe/ose jo publike të hidrocentraleve, financimi, vënia në punë, administrimi, prodhimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, ndërtimi i linjave të transmetimit të energjisë elektrike për tregtimin e saj, konsulencë teknike në fusha të ndryshme, supervizim, menaxhime dhe studime të të gjitha llojeve, etj..

Target: *Energy Plus SHPK*, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: ndërtimin në lumin Luma në rrethin e Kukësit të hidrocentralit “Pobreg” operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë financimin, ndërtimin, vënien në punë, prodhimin, furnizimin, transmetimin, shpërndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjisë elektrike të përftuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin

10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.